

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Akuzat për kushtet e sportistëve të 'EUSA Combat 2026', Gonxhja: Fotot nuk janë nga ambientet ku qën drojnë delegacionet
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/akuzat-per-kushtet-e-sportisteve-te-eusa-combat-2026-gonxhja-fotot-nuk-j-i585842
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 15:47:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 16:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	edc86bdb32b5d887c9cae8285a8894e76dd3dbb6eaa4686380a102de6f4d6cf
TEKSTI	44556beaef7ff536493ae3dd7f5cda95252ff0edf365103f78e2f6d9c40f43a8
PAMJA	56f4cac49abb06a87f362e13539e1af24e4b83c4118bedca607e710762439a5d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f89f31e8e3e853f22a2ae600016956c07145d05f94b780020b76bba209b136e8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f89f31e8e3e853f22a2ae600016956c07145d05f94b780020b76bba209b136e8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

[English](#)

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

[English](#)

1 e Arabia Saudite rrezikon rezervat e natësKreth 1.30 persona të zhdukur pas mbytyjes së një anijeje në Indonezi, 6 viktimaAngli/ Denohet agjenti imobiliar, i siguroi shqiptarëve 19 shtepi për të mbijë fundit

Akuzat për kushtet e sportistëve të 'EUSA Combat 2026', Gonxhja: Fotot nuk janë nga ambientet ku qëndrojnë delegacionet

13 Shtator 2026, 18:00Sociale TEMA



Akuzat për kushtet e sportistëve të 'EUSA Combat 2026',

Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Blendi Gonxhja, ka reaguar lidhur me disa postime të publikuara online mbi kushtet e akomodimit të sportistëve, që marrin pjesë në kampionatin EUSACombat – Tirana 2026.

Në reagimin e tij, Gonxhja i ka cilësuar pretendimet si të pasakta, duke theksuar se ato nuk pasqyrojnë situatën reale dhe krijojnë një panoramë të shtrembëruar të organizimit të aktivitetit.

Kampionati po zhvillohet në Tiranë nga 7 deri më 17 shtator, me pjesëmarrjen e mbi 1,600 sportistëve dhe shoqëruesve universitarë nga rreth 400 universitete të 38 vendeve europiane. Garat zhvillohen në disiplinat e taekwondos, karatesë, xhudos dhe kickboxingut.

Sipas ministrit, organizimi i aktivitetit i takon tërësisht Federatës Shqiptare të Sportit Universitar, e cila ka kërkuar mbështetje financiare nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, të ofruar në shkurt të vitit 2026.

Sa u përket fotografive të publikuara në rrjetet sociale, Gonxhja deklaroi se ato nuk u përkasin ambienteve ku janë sistemuar pjesëmarrësit e kampionatit.

Për këtë arsye, ministri e konsideron paraqitjen e këtyre pamjeve si ambiente ku qëndrojnë delegacionet e huaja, të pavërtetë dhe keqinformuese.

Deklarata e plotë:

Sqarojmë se pretendimet e ngritura nuk pasqyrojnë situatën reale dhe krijojnë një panoramë të shtrembëruar. Kampionati zhvillohet në Tiranë nga 7 deri më 17 shtator 2026, me pjesëmarrjen e mbi 1,600 sportistëve dhe shoqëruesve universitarë nga rreth 400 universitete të 38 vendeve europiane, në disiplinat taekwondo, karate, xhudo dhe kickboxing. Aktiviteti organizohet tërësisht nga Federata Shqiptare e Sportit Universitar, e cila ka kërkuar një mbështetje financiare nga MTKS, që iu ofrua në shkurt 2026.

Sipas informacionit të përcjellë nga federata organizatore, Bashkia Tiranë kishte marrë përsipër dhe kishte lëshuar garanci për akomodimin e rreth 1,500 pjesëmarrësve. Kjo garanci, ka qenë pjesë e kushteve mbi të cilat EUSA miratoi zhvillimin e kampionatit në Shqipëri. Vetëm pak ditë përpara fillimit të aktivitetit, organizatorët janë njoftuar se kapacitetet e parashikuara fillimisht nuk mund të vihehin plotësisht në dispozicion, pasi një pjesë e dhomave ishin të zëna nga studentë shqiptarë me kontrata njëvjeçare. Për të mos cenuar strehimin e tyre dhe për të garantuar vazhdimësinë normale të aktivitetit, një pjesë e delegacioneve është sistemuar në Kamëz, në ambiente të vlerësuara si më të përshtatshme.

Pavarësisht se Ministria nuk ka asnjë përgjegjësi direkte organizative apo logjistike, zëvendësministri përgjegjës për sportin ka qenë personalisht i pranishëm në momentet e mbërritjes dhe pritjes së delegacioneve, duke shprehur gatishmërinë e plotë institucionale për të ndihmuar në adresimin e çdo nevojë që mund të paraqitet. Duhet kuptuar se aktivitetet të këtyre përmasave, kudo në Europë, nuk mbështeten në standardet e hoteleve superiore. Për akomodimin e mijëra sportistëve të rinj përdoren zakonisht kampuse universitare, rezidenca studentore, hostele rinore dhe njësi ekonomike akomodimi, duke garantuar kushtet e nevojshme të sigurisë, higjienës dhe funksionalitetit, edhe në funksion praktikiteti.

Imazhet e publikuara në rrjetet sociale, nuk u përkasin hapësirave ku janë sistemuar pjesëmarrësit e kampionatit. Nga verifikimet e kryera rezultoi se ato mund t'u përkasin godinave të tjera të vjetra, të pabanuara e në pritje të rikonstruksionit. Paraqitja e këtyre pamjeve si ambiente ku qëndrojnë delegacionet e huaja është, për rrjedhojë, e pavërtetë dhe keqinformuese.

Në një aktivitet me mbi 1,600 pjesëmarrës, ku intervalet e zhvendosjeve e pauzave janë minimale, të pastrosh e të mirëmbash dhoma e ambiente sanitare kërkon turne e kapacitete të shtuara. Njëkohësisht, kërkohet bashkëpunim dhe respektim i rregullave edhe nga vetë përdoruesit, veçanërisht për mbetjet dhe sjelljen brenda dhomave dhe hapësirave të përbashkëta. Situata të veçuara nuk mund të paraqiten si prova të mungesës së angazhimit në të gjithë strukturën akomoduese.

Asnjë ushqim apo shërbim jashtë standardeve nuk është konstatuar nga strukturat përgjegjëse. Shërbimi i ushqimit dhe çdo element tjetër organizativ kontrollohen vazhdimisht nga organizatorët dhe ekipi ndërkombëtar i aktivitetit. Çdo mangësi apo parregullsi e evidentuar komunikohet drejtpërdrejt dhe trajtohet në kohë reale. Përfaqësuesit e EUSA-s kanë inspektuar nga afër edhe ambientet e akomodimit, duke u njohur drejtpërdrejt me kushtet reale.

Organizatorët po punojnë për mbarrëvajtjen e kampionatit, ndërsa Ministria, brenda rolit të saj ligjor dhe institucional, mbetet e gatshme për të kontribuar në adresimin e çdo nevojë që mund të kërkojë masa e zë. Çdo problem konkret duhet të trajtohet me përgjegjësi, por nuk mund të pranohet që raste të izoluara, fotografi të paverifikuara apo ambiente që nuk përdoren nga delegacionet të shërbejnë për të cenuar një aktivitet madhor ndërkombëtar dhe imazhin e Shqipërisë si vend mikpritës.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Ndryshon ligji për legalizimet, kushte për zonat ku parashikohet ndërtimi i pallateve](#)

13:50 Sociale / 2 komente

[Vjeshta shuan flakët! “Mbroytja”: Asnjë vatër aktive. U fikën zjarre në Dibër, Lezhë, Elbasan...](#)

11:45 Sociale

[Lindjet vazhdojnë të bien, bonusi i bebes drejt ristrukturimit](#)

11:40 Sociale / 2 komente

[Stuhia godet Elbasanin, uji pushton banesa, bodrume dhe parkime nëntokësore](#)

11:00 Sociale / 3 komente

[Salla: Arsimi profesional bujqësor, lidhje e drejtpërdrejtë me prodhimin dhe biznesin](#)

21:10 Sociale

[Hapësirat e pashfrytëzuara në shërbim të komunitetit - Bashkia e Tiranës i kthen në kënde lojërash dhe mjedise çlodhjeje](#)

19:40 Sociale / 3 komente

[Specialistët e Kadastrës “zbarkojnë” në Piqeras, po punohet për evidentimin e regjistrit kadastral](#)

19:10 Sociale / 4 komente

[20 shkolla të Tiranës me kamera inteligjente](#)

17:00 Sociale / 3 komente

[Check Up falas mbi 35 vjeç - ISHP: Analizat do të pasqyrojnë faktorët e rrezikut në popullatë](#)

16:10 Sociale / 3 komente

[120 notarë kalojnë nga Ksamili në Korfuz](#)

15:20 Sociale / 4 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Unë jam me Petrit Malajn](#)

14:45 Blog / 60 komente

[‘Det’ pjesëmarrësish në ‘Marshin për liri’ në Prishtinë: ...](#)

15:15 Rajoni / 74 komente

[BE reagon para vendimit për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-s...](#)

14:30 Rajoni / 33 komente

[John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?](#)

11:40 Blog / 21 komente

[VIDEO/ Edi Rama: Karakaçi, ministër i shkëlqyer. Balluku ...](#)

10:02 Politika / 7 komente

Blog Tema

[Kur pushteti politik abdikon ndaj atij gjyqësor](#)

16:13 Blog / 7 komente

[Shënime nga Konventa e Teksasit në ShBA](#)

12:00 Blog / 41 komente

[EuReporter artikull për kryebashkiakun, Veliaj deklaron: "Ende nuk e kam humbur shpresën"](#)

10:30 Blog / 9 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

Tema është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, Tema është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

• [Politika](#)

• [Sociale](#)

- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)

- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.